



Nëse keni ambicie për zhvillim profesional në një mjedis dinamik, me kushte dhe atmosferë të shkëlqyer pune, aplikoni në njoftim dhe bashkohuni me ekipin tonë!

UNI Banka AD Skopje ka nevojë për kandidatë të motivuar për punësim në pozicionin e mëposhtëm të punës:

Nëpunës në front office - Dega Tetovë

Ju duhet të zotëroni:

- Diplomë e shkollës së mesme/diplomë e shkollës së lartë;
- Aftësi të shkëlqyera komunikimi;
- Aftësi për të punuar në ekip;
- Pozitiv, përgjegjës dhe i përkushtuar;
- Njohuri të paketës MS Office;
- Motivim i lartë për të arritur objektivat e vendosura dhe për të fituar njohuri të reja;

Përgjegjësitë kryesore:

- Njoh produktet dhe shërbimet bankare dhe i promovon, sugjeron dhe i shet ato;
- Merr pjesë në operacionet e vazhdueshme të degës dhe në marrjen dhe përcjelljen e kërkesave të klientëve;
- Kryen detyrat e punës në kohë dhe të saktë dhe ruan një nivel cilësor shërbimi;
- Kujdeset vazhdimisht për nevojat e klientëve;
- Mban marrëdhënie pozitive pune me subjektet e brendshme dhe të jashtme;
- Kujdeset dhe sugjeron mundësi për të rritur fitimin në degë;

Përfitimet:

- Politikë shpërblimi përmes një sistemi bonusesh;
- Trajnim për zhvillim personal dhe profesional;
- Sigurim kolektiv aksidentesh, sigurim shëndetësor shtesë;
- Aktivitete sportive dhe aktivitete tim biding;

Orari i punës është 8 orë në ditë, ose 40 orë në javë, nga e hëna deri të premten.

Nëse jeni një person i përgjegjshëm, i saktë dhe aktiv, i orientuar drejt arritjes së rezultateve të larta, bashkohuni dhe Ju me ekipin e suksesshëm të profesionistëve!

Ne u ofrojmë punonjësve tanë punë dinamike me mundësi për zhvillim dhe avancim profesional, si dhe kushte të shkëlqyera pune në një mjedis me një ekip ambicioz dhe profesional.

Kandidatët e interesuar që plotësojnë kërkesat e mësipërme duhet të dërgojnë një CV të shkurtër në gjuhën maqedonase në adresën jobs@unibank.com.mk, jo më vonë se 06.08.2025.

*Aplikimi juaj do të trajtohet me konfidencialitet të rreptë. Vetëm kandidatët që plotësojnë kualifikimet dhe kushtet e nevojshme do të ftohen për intervistë. Procesi i përzgjedhjes do të finalizohet brenda afatit të kërkuar me ligj, varësisht nga numri i aplikantëve. Duke aplikuar për këtë pozicion pune, ju pranoni që Banka mund të mbledhë, përpunojë dhe ruajë të dhënat tuaja personale për nevojat e procesit të rekrutimit për të gjithë kohëzgjatjen e tij, dhe pas përfundimit të tij, të dhënat mund të ruhen në bazën e të dhënave të Bankës për qëllime rekrutimi në përputhje me rregulloret ligjore. Ju mund ta tërhiqni pëlqimin tuaj në çdo kohë duke paraqitur një kërkesë në linkun e mëposhtëm: zlp@unibank.com.mk